



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.36/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, dega në Lipjan paraqitur kundërsujektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të vendosjes së flamujve të subjektit politik në shtylla elektrike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Lipjan me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Me datën 22.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me të cilën pretendon se me datën 21.09.2017 ka vërejtur se në rrugën “Lidhja e Prizrenit” në Lipjan nëpër shtylla elektrike janë vendosur flamuj të subjektit politik LDK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik LDK ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pikës b) është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë të datës 23.09.2017, thekson se vendosja e flamujve përgjat rrugëve në shtyllat elektrike të cilat janë të përshtatura ekskluzivisht për vendosjen e flamujve në solemnitete të ndryshme por edhe në fushata të këtilla zgjedhore, në asnjë rast nuk mund të përbëjë shkelje të dispozitave të ligjit apo të cilësdo rregull që rregullon këtë segment të zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se flamujt e subjektit politik LDK janë të vendosur në shtylla elektrike, janë të qendrueshme mirëpo paneli ka vlerësuar se vendosja e flamujve lëndor

janë të vendosur ne vendin e dedikuar për vendosjen e të njëjtëve, ashtu siç vërtetohet nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqendrueshme prashkrimet në ankesë së është Thyer Kodi i Mirësjelljes nga subjekti politik LDK. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL. Anr.36/2017 më datën 25.09.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.